

Edona JAHU
FJALORI I HUAJ TEK ADOLESHENTËT E PRISHTINËS
(NDIKIMI I GLOBALIZMIT)

Abstrakti: Në këtë studim do të merremi me zotërimin e fjalorit të huaj tek adoleshentët, në formësimin e të cilit vazhdon të ketë ndikim mbivlerësimi i gjuhës universale, anglishtes. Përballja me këtë gjuhë është rezultat i depërtimit global, që në vend të zgjerimit të dijeve, folësi/ja i fut huazimet, duke i eliminuar, zëvendësuar apo minimizuar fjalët shqipe. Trysnia e gjuhës angleze është aq e fuqishme, qoftë në teknologji e rrjete sociale, sa adoleshentët arrijnë ta kuptojnë në shkallë të kënaqshme njëri-tjetrin pa bërë kurs të veçantë. Kjo ndodh, për shkak se të rinjtë janë ata që ndjekin trendin botëror, i cili mundëson shkëmbimin e fjalëve kulturore. Priremi ta vëmë theksin tek adoleshentët, të cilët në këtë fazë, arrijnë nivel të përparuar të të shprehurit, meqë krijojnë repertorët gjuhësorë shoqërorë. Janë incizuar 68 biseda spontane në ambiente joformale, të cilat përbëjnë korpusin e punimit.

Fillimisht, do të japim sqarime teorike për globalizmin, sociolektet, më pas do t'i shohim konkretisht fjalët e huaja, të cilat janë nxjerrë nga bisedat mes të rinjve. Kontaktet e vazhdueshme, nami kulturor, si motiv shtesë, e kanë bërë anglishten lingua franca. Zhvillimi i leksikut na lidh me psikolinguistikën, derisa ndikimi i tyre është social, që na shtron nevojën për qasje sociolinguistike. Kemi vënë re se huazimet, përpos në gjuhën akademike, kanë hyrë dendurisht në fjalorin e përditshëm, si rrjedhojë e internetit dhe bashkëpunimit kulturor e ekonomik mes shteteve. Kjo mundësohet nga aspekti kreativ i gjuhës, që u jep mundësi folësve të eksplorojnë me gjuhë, të realizojnë kombinime gjuhësore. Kemi ndikim të faktorëve psiko-socialë dhe edukativë.

Fjalë kyçe: fjalori i huaj, adoleshentët, anglishtja, globalizmi, faktorë psiko-socialë

Hyrje

Gjuha është në marrëdhënie me folësit e saj, në kuptimin që, aspekti kreativ i saj, u shërben atyre për të krijuar mënyra të reja të të shprehurit, varësisht nga dëshira për t'u identifikuar me ndonjë grup shoqëror. Janë ata që e shkaktojnë heterogjenitetin dhe shtresimin socio-ekonomik edhe në aspektin gjuhësor.

Rrethi shoqëror i një personi përbën njerëzit me të cilët, krahas familjes, kalon përmasat më të spikatura kohore në moshën e adoleshencës e tutje, duke ushtruar ndikim në gjuhë: shpeshtësi të përdorimit të disa fjalëve, ndërtime të gabuara qëllimisht, rend të fjalëve, përdorim të fjalëve të huaja nofka për shoqërinë e afërt etj. E nëse e shikojmë më hollësisht variacionin në stilin e të folurit, mund ta shohim se nuk luan rol vetëm klasa shoqërore dhe vëmendja ndaj bisedës, por gjithashtu, varet edhe nga mendimi i dëgjuesve për personin që flet.

Ky studim do të ndalet te leksiku i huaj i adoleshentëve prishtinas, që me kalimin e kohës, bëhet më dendurisht i pranishëm, si pasojë e faktorëve psiko-socialë.

Fillimisht, do të sqarohet shkurtimisht globalizmi – si proces që ka ndikuar në çdo fushë jetësore dhe ua ka rritur njerëzve mundësinë për të bashkëpunuar, që, krahasuar me disa dekada më parë kur kishte kufizim të interaksionit, tani janë hapur mundësitë

ndërkomunikuese. Konceptohet si dukuri e jashtëzakonshme, e cila ka mundësuar informimin për çdo ngjarje që ndodh.

Më pas, do të kalohet te sociolektet, shpjegimi i të cilave ndërlidhet me fjalorin e huaj që është aktiv te të rinjtë dhe do të jepen shembujt konkretë. Me anë të paraqitjes së fjalëve, si kategori gramatikore (emra, folje), e qartësojmë se tiparet ligjërimore të të rinjve kushtëzohen nga shoqëria e ngushtë, por edhe rrjetet sociale.

Metoda

Për të arritur t'i identifikojmë këto fjalë, janë incizuar gjithsej 68 biseda në klasë ose në kafene mes 84 nxënësve 16-18-vjeçarë të gjimnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë. Mosha e tyre tregon se janë edhe në fazë të formimit leksikor dhe kanë ndikim nga jashtë, marrë parasysh anglishten – si gjuhë universale.

Nga këto biseda, janë veçuar fjalët (të klasifikuara në kategori gramatikore) e fjalitë ku janë gjetur fjalë të huaja dhe janë paraqitur konkretisht në punim.

1. Globalizimi

Sipas wikipedias, globalizmi është procesi i interaksionit dhe integritit mes njerëzve, kompanive në të gjithë botën. Ky proces ka mundësuar komunikimin botëror, shkëmbimin e informacionit për çdo ngjarje shpejt dhe lehtë në çdo kënd të botës. Gjithashtu, jep mundësinë e zhvillimit kulturor, tregtar, rrit konkurrencën – rrjedhimisht, cilësinë e shumë produkteve anembanë globit.

"Globalizmi, në radhë të parë, duhet të shihet dhe vlerësohet si dukuri sociologjike, që manifestohet pothuajse në të gjitha sferat e jetës së njeriut" (Munishi 2015:18). Sipas tij, ndikimi i këtij fenomeni ka bërë që ndryshimet shoqërore në jetën e bashkësive shoqërore anekënd botës të jenë shumë më të shpejta se në të kaluarën.

Sipas Giddens (1990), "globalizimi është intensifikimi i relacioneve shoqërore botërore, të cilat i lidhin lokalitetet e largëta në atë mënyrë që ndodhitë lokale janë të formuara nga ngjarjet që ndodhin shumë milje larg dhe anasjelltas.

Kjo ka ndikuar edhe në zhvillimin e shumëgjuhësisë – mundësinë për të mësuar gjuhë botërore, në veçanti anglishten – si gjuhë mbizotëruese që ka pushtuar dhe ka fituar epërsi në tërë botën. P.sh. nëse zhvillohet një takim zyrtar, "gjuha e përbashkët" do të jetë ajo angleze, në rast të mosnjohjes së gjuhës së tyre native nga bashkëbiseduesit. Kjo tregon se kjo gjuhë ka shërbyer si unifikim për komunikim, si rezultat i përhapjes dhe shndërrimit në një gjuhë universale, *lingua franca*. Warschauer (2000) thotë se anglishtja është bërë urë mes kulturave në botë. Sipas tij, nëse në shek. XXI ka pasur kontradiktë mes rrjeteve globale dhe identiteteve lokale, anglishtja është mjet i të dyjave. Ajo ka homogjenizuar relacionet botërore shoqërore. Ndërsa, Cook (1991) thotë se një amerikan ose anglez nuk ka më shumë të drejtë t'i thotë një tanzaniani që ta mësojë anglishten më shumë se një kinez. Pra, njohja e saj është në favor të çdokujt, pavarësisht se cilit nacionalitet i përket, meqë, ndër të tjera, lehtëson koordinimin e aktiviteteve shoqërore mbarëbotërore. "Na kërcënon sot rreziku i një "shqipanglitalishteje", prandaj në qoftë se nuk

duam që një shqipe e përçudnuar të përçudnojë edhe mendjen e shqiptarëve, duhet që shteti dhe krejt shoqëria e qytetëruar shqiptare të shkunden nga letargjia dhe të dalin nga megjullnaja e kësaj shqipanglitalishteje që rrezikon të na kaplojë” (Shkurtaj 2003:78). Por, nuk do ta përkrahim këtë qëndrim, sepse duhet t’u jepet liri folësve që vetë t’i përzgjedhin mënyrat e të shprehurit dhe nuk mendojmë se shqipja është në stadin e një nevoje të reformës gjuhësore. Është e dobishme të ketë laramani gjuhësore në grupe shoqërore.

2. Sociolektet

Sociolekti është varietet i të folurit, që lidhet me grupe të caktuara shoqërore dhe ua bën folësve anëtarë të grupit më të lehtë, përkatësisht më të fshehtë komunikimin. Ata janë të lirë që t’i përzgjedhin vetë format gjuhësore me të cilat duan që të identifikohen ose të shprehen kur flasin me njëri-tjetrin. “Në studimin e sociolekteve, është klasa shoqërore ajo që parimisht përdoret për t’i ndarë grupet e folësve që kanë diçka të përbashkët.” (Yule 2010:254).

Ajo që e dallon sociolektin nga gjuha e përditshme apo ajo standarde, është repertori leksikor i ngushtuar për një grup, ndërtimet e veçanta sintaksore, që e ndajnë dhe e diferencojnë atë nga grupet e tjera. Siç thotë edhe Holmes (2015:165): “çdo dialekt shoqëror mund të përkufizohet si një kombinim i caktuar stilesh ose nivelesh, ku çdonjëri syresh ka modelet e veta të dallueshme të leksikut, të gramatikës dhe të shqiptimit, ndonëse nivelet e ndryshme stilistike kanë edhe shumë forma të përbashkëta”.

Si rezultat i rrjeteve sociale, internetit në përgjithësi, leksiku i adoleshentëve është mjaft i pasur me anglicizma. Këtu nuk po flasim për terminologjinë shkencore, fjalë për të cilat shqipja ka nevojë të domosdoshme për t’i përmbushur zbrazëtitë leksikore, por fjalë të përditshmërisë apo huazime leksikore që i kanë të barasvlershmet e tyre në shqipe dhe kanë hyrë në shtresën aktive të fjalorit, veçanërisht të rinjtë. Është e vërtetë se një pjesë e tyre hyjnë si ndërkombëtarizma, por ato janë shndërruar edhe në sociolekte, duke e marrë kuptimin e përcaktuar nga vetë grupet shoqërore.

2.1 Fjalët e huaja si sociolekte

Ndikimi i anglishtes shfaqet në diskursin e të rinjve, madje, jo vetëm si fjalë rastësore, por edhe si sociolekte. “Njerëzit që marrin pjesë në situata të përsëritura, kanë një leksik të ngjashëm, tipare të përafërta të intonacionit dhe karakteristika të përbashkëta sintaksore” (Ferguson 1994:20). Kjo d.m.th. se të folurit e secilit realizohet gjithmonë nën ndikimin reciprok mes personave që kalojnë pjesën dërrmuese të kohës bashkë, duke ndërvepruar gjuhësisht. E, meqë grupet shoqërore ndryshojnë në pikëpamje, “shenjohen” me disa veçori, në një grup ka mundësi të përjashtohesh ose të pranohesh. Me integrimin e fjalëve angleze, ekziston mundësia që të shndërrohen në fjalë shënjuese të grupeve sociale. Raste të anglicizmave si sociolekte kemi p.sh.

një grup djemsh, kur e nxisin shokun ta bëjë për vete ndonjë vajzë thonë *fulle* – *foli*, *vardisju*, pastaj për të luajtur sony *legoo* (*let’s go*)- *le të shkojmë*, shokun më të ngushtë *nigga*.

Një grup vajzash e thërrasin një vajzë të caktuar *Queen* dhe anëtarët e grupit e kanë të qartë referencën. S' di a pranon *kingu* – i njëjti rast. Në këto raste, fjala angleze është e kuptueshme vetëm për grupin shoqëror, dhe është e nevojshme vetëm njohja e kuptimit nga anëtarët e atij grupi.

Pra, anglishtja ka përforcuar së tepërmi mundësinë për rritjen e kreativitetin në formimin e fjalëve sociolektale. Këto përzierje të kodit nuk janë pa kriter dhe të pamenduara, por krejtësisht të motivuara dhe të planifikuara nga grupi shoqëror.

Më poshtë do të shtresohen fjalët e huaja, në bazë të kategorisë gramatikore së cilës i përkasin.


3. Prania e fjalëve të huaja tek adoleshentët

Nuk ka gjuhë pa huazime, por fjalët në rastin tonë, përdoren nga të rinjtë, edhe kur kanë të barazvlershmet në shqipe. Kjo ndodh për t'u shfaqur më të zgjuar, më misteriozë, madje fusin fjalë të huaja pa vetëdijen e tyre.

Si tipare relevante për studim, hyjnë shqiptimet e ndryshme, strukturat e fjalëve dhe gjithashtu përzierja e kodeve, meqë të rinjtë, të vetëdijshëm për prestigjin e gjuhës angleze, përdorin qëllimisht fjalë në anglishte – që janë qendër e këtij punimi. Pra, gjuha e tyre është e pasur me fjalë të huaja, sepse të rinjtë kanë përshtatur leksikun e anglishtes – kryesisht fjalët që janë më të përdorshme.

Fillimisht, do të jepet analiza e ca fjalive të artikuluar nga adoleshentët gjatë incizimit të bisedave, që në vete e përmbajnë ndonjë fjalë të huaj, më pas, do të përshkruhen fjalët e hasura, pas bisedave, me raste – nxitjes për t'i përdorur ato.

Njohja e gjuhës universale, është bërë domosdoshmëri në ditët e sotme. Të pyetur se sa e zotërojnë gjuhën angleze, respondentët kanë dhënë këto përgjigje:



61% prej tyre janë deklaruar se e njohin shumë mirë gjuhën angleze, derisa 39% thonë se e njohin mirë. Edhe ata që nuk e njohin mirë, pohojnë se fjalët më dëndurisht të përdorshme i përvetësojnë nga shoqëria, interneti, familja etj. Gjithashtu, disa krijojnë qëllimisht gjuhë të

pakuptueshme për prindërit e tyre. Këtë ndikim e shohim të konkretizuar te shembujt e mëposhtëm.

3.1 Fjalitë

Po japim sekuenca tëdisa bisedave mes shoqeve:

Zemër llajkma foton që m'ki tagirat – siç e shohim, fjalët shqipe *pëlqim, etiketim* nuk aplikohen kur flitet për facebook. Pastaj, *i dellita krejt çka s'i knowi*, - preferohet të thuhet *i dellita* në vend të *i fshiva*. *Ia bona add, tash s'di a pranon kingu* – në vend të *e shtova*. Këtu, rol ka edhe ekspozimi i syrit ndaj një fjale të caktuar – më pas thjesht i pasngjiten prapashtesat aktive në gjuhën shqipe.

Bonja copy paste.- edhe kjo strukturë ka denduri përdorimi te të rinjtë

Okej, thanks loçkë për krejt – këto dy fjalë kanë përhapje enorme do të thoshim, nga të gjitha grupmoshat, fakt që pranohet nga të gjithë shqipfolësit. Gjasat që të përdoret *në rregull*, në vend të *ok* –janë të vogla. Nuk kërkohet shkallë e lartë zgjuarsie për t'i kapur fjalët e tilla, sepse tani janë bërë pjesë e pandashme e shoqërisë kosovare. Megjithëse në leksikun e tyre mendohet janë edhe fjalët shqipe – kushtet sociale, shpeshësia e dëgjimit të fjalës angleze, ua imponon që ta zgjedhin fjalën angleze për përdorim.

Në këto raste, kemi përzierje kodi, jo ndërrim kodi, sepse vetëm fjalë të caktuara gjatë rrjedhës së bisedës janë të huaja dhe jo për shkak të mosdijes së fjalës shqipe, por përdorim të qëllimshëm për arsye prestigji, dëshire për t'u treguar i integruar në shoqëri.

3.2 Foljet:

Foljet përbëjnë klasë mjaft të pasur me huazime në ligjërimin e të rinjve.

t'llovi, po tfilliti, ta llajka foton, checkiratëm, e gugllirataia bona like, ia bona add (e addirata, e dellita, e bukirata, tagiratem, fullirat, osht haku (hakirat), bonja search, trejnirat, e boj pak bllurr (e errësoj), suportomë, restartoje, - siç e shohim, fjalët e huazuara i janë nënshtruar sistemit fonetik dhe morfologjik të shqipes, duke i përshtatur fjalët me prapashtesat fjalëformuese të shqipes –it (që nga origjina është sllave), fjala angleze + irat, pastaj folja bëj + fjala angleze, u pasngjiten trajtat e shkurtra të përemrit vetor. Ato përshtaten saktësisht me gramatikën e shqipes.

3.3 Emrat (grupe emërore)

Emrat, gjithashtu hasen mjaftueshëm në leksikun e adoleshentëve

oj disaster, loser, champion, singer, boss, ausllander, nigga, oldschool, princess, pinkgirl, nails, downlodime.

Emra konkretë: *pc-ja, iphoni, teacher, my pen*

Nofka me ngjyrim pozitiv *honey, sweetie, my heart, my all,*

Të tjera: *ok, thanks, Merci, how are you, fine, fine, hello, hajj, passwordin*

(*fjalëkalimin*), *justkidding, you are the best, okej, brb (be right back), i love you, what's up, let's start, finish the gaame, horror*

Përdorimin e këtyre fjalëve, veçanërisht ndaj atyre që nuk kanë njohuri për gjuhën p.sh. prindërit, e shohin si shenjë mbrojtëse, për të mos u kuptuar domethënia e fjalive, pasaktësi të qëllimshme semantike.

E pamë qartë impaktin e gjuhës angleze në diskursin e të rinjve, që në raste të caktuara, fjalët e kësaj gjuhe shërbejnë për t'i përfaqësuar në grup. Këto fjalë të huaja nuk e pengojnë komunikimin, meqë për t'u zhvilluar ai, thjesht duhet të dekodifikohet saktë përmbajtja e fjalës nga dëgjuesi, e s'd.m.th. patjetër të jetë në shqipe, vetëm pse kemi të bëjmë me shqipfolës.

Edhe pse i kanë në mendje fjalët shqipe, përzgjidhet varianti i gjuhës angleze që e fiton garën në leksikun mendor.

Statistika

Kategoria	Numri i herëve	Përqindja
Njësi sintaksore (fjali)	22	17.82%
Foljet	19	15.39%
Emrat	17	13.88%
Të tjerat	23	18.63%

Në 68 biseda janë vërejtur këto të dhëna, që përbëjnë deri diku numër të konsiderueshëm në përdorim të anglicizmave si fjalë sociolektale, si rrjedhojë e hasjes së tyre në rrjete shoqërore, televizion etj. Emrat dhe foljet kanë mjaft përhapje të gjerë. Te fjalitë i kemi futur rastet kur janë hasur edhe folja edhe kundrina ose ndonjë fjalë falënderuese në të njëjtën thënie: *Ia bona add, tash s'di a pranon kingu* dhe kur rendi foljor është i bazuar në kalke *lodh jom, knaq jem*. Kjo tregon edhe dendurinë e shfaqjes, madje në një fjali të vetme.

Përfundime

Në fund, mund të themi se globalizmi i ka afruar popujt dhe kulturat e ndryshme, duke e bërë çdo cep të botës si një vend lehtësisht të arritshëm, si një shoqëri të vetme. Siç e pamë, bashkëpunimi me anglishten është materializuar në shqipe, duke krijuar vend shumë fjalë në leksikun mendor të adoleshentëve, madje shumë prej tyre konceptohen si fjalë sociolektale, zakonisht ato që nuk kanë denduri përdorimi në grupet e tjera – për të qenë të qarta vetëm për persona të caktuar, sipas marrëveshjes paraprake. Prandaj, mund të thuhet se fjalët e huaja shpesh janë taktikë për t'u kuptuar më lehtë nga anëtarët e grupit shoqëror. Në fakt, është e pamundur të frenohet depërtimi i tyre. Arsyeja për këtë është se anglishtja i ka shtrirë kufijtë në tërë botën dhe njihet si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, për shkak të dominimit ekonomik dhe kulturor

Në një përqindje të konsiderueshme të fjalëve sociolektale dalin të jenë fjalët e huaja, që përzgjidhen nga anëtarët e një grupi shoqëror, kryesisht për t'u dukur më të ngritur ose për të mos u kuptuar nga të tjerët. Kjo gjuhë i ka shkrirë kufijtë mes vendeve. Njëkohësisht, siç e pamë, ka krijuar risi leksikore në repertorin e të rinjve.

Krejt këto janë pasojë e drejtpërdrejtë e ndikimit të anglishtes në shqipe, televizionit – që e promovon këtë gjuhë, sa herë që ka folës të gjuhëve të ndryshme.

Bibliografia

- Cook, V. 1991. *Second Language Learning and Language Teaching*. London: Edëard Arnold
- Giddens, Anthony (1990) *The Consequences of Modernity*. Cambridge: Cambridge University Press
- Holmes, J. 1992. *An Introduction to Sociolinguistics*. London: Longman. (përkthyer në shqip më 2015 nga Kristina Jorgaqi; Irena Kapo).
- Munishi, Sh. 2015. *Shqipja në epokën e globalizmit*. Prishtinë: ZeroPrint
- Shkurtaç Gj. 2003, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe* Tiranë: "Kristina"
- Warschauer, M. 2000. *The changing global economy and the future of English teaching*. TESOL: Quarterly
- Yule, G. 2006-2010. *Language and social variation*. In *The Study of Language* (4th edition) Cambridge, UK: Cambridge University Press.